




Platforma Regjionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të
Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve
Western Balkan's Regional Platform for Advocating
Media Freedom and Journalists' Safety

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve [KOSOVA]

PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE



**Treguesit e nivelit
të lirisë së mediave
dhe sigurisë së
gazetarëve
[KOSOVA]**

PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

**Autor: Petrit Çollaku
Dhjetor 2018**

Titulli origjinal

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve (Kosova) - Përmbledhja e të gjeturave

Botuesi

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Autor

Petrit Çollaku

Dizajni

Lavi studio - Montenegro

Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian dhe Mbretërisë së Holandës. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Asociacionit të Gazetarëve të Kosoves dhe autorit të publikimit, dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet që reflekton pozicionin e Bashkimit Europian ose Mbretërisë së Holandës.



This project is funded by
The European Union



Kingdom of the Netherlands

Përmbledhja ekzekutive	5
Përmbledhja e përgjithshme	5
Treguesit A: Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve	6
Treguesit B: Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës	7
Treguesit C: Siguria e gazetarëve	7
Pasqyrë e treguesve: Për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin perëndimor	8
A. Mbrojtja Ligjore e Lirisë së Medieve dhe Gazetarëve	9
B. Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës	18
C. Siguria e gazetarëve	24

Përmbledhja e përgjithshme

Ky raport paraqet të gjeturat e hulumtimit të tretë të zhvilluar në kuadër të projektit rajonal Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të Lirisë së Medieve dhe Sigurisë së Gazetarëve¹, të zbatuar nga asociacionet e gazetarëve në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Raporti është vijueshmëri e studimit bazë², i cili ka paraqitur gjerësisht gjendjen e legjislacionit, çështjet socio-ekonomike dhe politike në lidhje me lirinë e medieve dhe sigurinë e gazetarëve si dhe ka identifikuar sfidat kryesore për asociacionet e gazetarëve dhe hisedarëve të tjerë. Qëllimi kryesor i këtij studimi kërkimor është zbulimi i zhvillimeve të reja dhe krahasimi me nivelet e lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve që janë identifikuar në vitin 2017.

Studimi kërkimor është kryer nga Petrit Çollaku sipas metodologjisë së përbashkët për 5 shtetet. Në vijim janë metodat e zbatuara për mbledhjen dhe analizën e të dhënave:

¹ Projekti është financuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programi i Mediave dhe Shoqërisë Civile 2014-2015, Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.

² Platforma Rajonale për Lirinë e Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve, Treguesit e Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve 2016, <http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/12/Raporti-i-plot%C3%AB.pdf>

- Analiza cilësore e dokumenteve (ACD) e studimeve hulumtuese dhe analizave të prodhuara nga organizata të tjera hulumtuese, akademikë, OJQ, hulumtues individualë etj.; e dokumenteve zyrtare të prodhuara nga institucionet publike (aktet ligjore, nënligjore, strategjitë, raportet vjetore, procesverbalet nga mbledhjet, njoftimet për shtyp) dhe e mbulimit medietik (tekste, artikuj, raportet e lajmeve dhe materiale të tjera të publikuara).
- Intervistat cilësore me 7 gazetarë
- Të dhëna zyrtare statistikore të kërkuara nga institucionet publike ose të mbledhura nga faqet e internetit në dispozicion ose nga burime të tjera të botuara.

Treguesit A: Mbrojtja ligjore e lirive të medieve dhe gazetarëve

Në përgjithësi, Kushtetuta e Kosovës dhe korniza ligjore përmbledhin normat dhe garancitë kryesore që mbrojnë lirinë e medieve dhe shprehjes ndonëse zbatimi i tyre në praktikë është i dobët. Sa i përket legjislationit për medie, në qershor të këtij viti, Komisioni parlamentar për medie ka miratuar, me vonesë projektligjin për Radiotelevizionin e Kosovës dhe tani është në shqyrtim nga deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Sivjet, ky komision ka inicuar edhe hartimin e Ligjit për Medie, pa sqaruar qëllimin e hartimit të tij. Nisma është kritikuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, përfaqësuesit e medieve dhe organizatat joqeveritare që merren me këtë fushë, duke theksuar se iniciativa ka për qëllim ushtrimin e ndikimit dhe kontrollit të politikës mbi mediet, veçanërisht 'në disiplinimin e portaleve'. (Seksioni A.1)

Autoriteti rregullativ perceptohet të funksionojë në mënyrë efikase. Sidoqoftë, procesi zgjedhor i bordit drejtues të Komisionit të Pavarur të Mediave nga Kuvendi i Kosovës shihet si shkëlqe e pavarësisë së tij. (Seksioni A.1)

Praktika e reklamimit të shtetit nëpër medie është përzgjedhëse dhe jo-transparente. Institucionet publike ndajnë fonde për reklama nëpër mediet online. Banerët nëpër portale nuk tregojnë ndonjë aktivitet të veçantë të ministrive. (Seksioni A.1)

Mediat e minoriteteve financohen nga buxheti i shtetit përmes transmetuesit publik, Radiotelevizioni i Kosovës. RTK-ja përfshin programet në gjuhët Serbe, Boshnjake, Turke dhe Rome. Që nga 2013, komuniteti Serb ka kanal lin e vet në RTK2. (Seksioni A.1)

Autonomia dhe pavarësia e transmetuesit publik është e garantuar me ligj por zbatohet dobët. Financimi i drejtpërdrejtë nga buxheti i Kosovës nuk siguron pavarësi dhe autonomi të transmetuesit publik. Ligji i ri pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës që parasheh kornizën financuese të përzier: 2,5 euro për amvisëri, që do të mblidhet përmes faturave të rrymës dhe 0.4 për qind ng buxheti i shtetit për projekte të veçanta të RTK-së. Sindikata e Pavarur e RTK-së ka reaguar disa herë duke kritikuar menaxhmentin për keqmenaxhim të financave dhe punësime pa kritere. (Seksioni A.1)

Dy gjykime janë mbajtur sa i përket pretendimeve kundër shpifjes dhe fyerjes, përfshirë një padi kundër një organizate mediale dhe tjetra padi nga një medium kundër një OJQ-je. Ekzistojnë më shumë se 50 padi të ngritura në Gjykatën Themelore të Prishtinës sa i përket shpifjes dhe fyerjes, që datojnë që nga 2010. Në disa raste, gjyqtarët janë vërejtur që marrin anë kur kanë sjellur aktgjykime dhe i kanë bërë të jenë politikisht të motivuar. Për shembull është rasti i gazetarit Vehbi Kajtazi i cili ishte fizikisht i sulmuar dhe gjykatësi në këtë rast solli aktgjykim prej katër muaj dënim me kusht për kryerësin e sulmit. (Seksioni A.2)

Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave ofrojnë garanci për pluralizmin politik në medie. Në përgjithësi, ekziston pluralizmi në mediet e Kosovës, duke përfshirë ato të transmetueshme, të shtypura dhe ato online. Gjatë zgjedhjeve, KPM-ja si organ i pavarur rregullues ka mandat për të monitoruar mediet. Gjatë periudhës jo-zgjedhore, mediat përfillin me Kodin e Mirsësjelljes së KPM-së që thekson se mediet nuk do të promovojnë interesat e një partie politike apo këndvështrimet e një partie politike. (Seksioni A.3)

Institucionet shtetërore kanë vazhduar edhe sivjet të jenë relativisht të mbyllura në komunikim me gazetarë. Autoriteteve publike, të cilave nuk u pëlqen raportimi i gazetarëve, shfrytëzojnë pozitën e tyre për t'i denigruar ata publikisht. (Seksioni A.4)

Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e gënjatur me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve që erdhi në fuqi në vitin 2013. Gazetarët theksojnë se ndjehen të lirë të mirëmbajnë kontakte me burimet e tyre. Nuk është regjistruar asnjë rast për ndonjë urdhër nga gjykata ndaj gazetarëve që të zbulojnë burimin. (Seksioni A.5)

Gazetarët theksojnë se ka raste kur ata janë refuzuar në të drejtën për qasje në dokumente publike dhe informacion nga institucionet publike. Projektligji për Qasje në Dokumente Publike është në proces e sipër dhe parasheh një komisioner si një trup të veçantë që do të ketë fuqi mbikqyrëse. (Seksioni A.6)

Treguesit B:
Pozicioni i gazetarëve në
redaksi, etika profesionale
dhe niveli i censurës

Gazetarët kanë theksuar se komuniteti vazhdon të punojë në kushte jo të mira të punës dhe me paga të ulëta. Mungesa e kontratave të punës mbetet problem për këtë komunitet duke krijuar atmosferë pasigurie në punën e tyre. Sivjet, një numër i gazetarëve dhe kameramanëve e kanë denoncuar publikisht punëdhënësin se nuk ua ka paguar për disa muaj rrogat, tatimet dhe kontributet pensionale. (Seksioni B.1)

Mediet online vazhdojnë të vërshojnë skenën mediale ndërsa numri i përgjithshëm i tyre mbetet i panjohur. Shumë sosh nuk i kanë të paraqitura informacionet se kush janë pronarët dhe kush punon në redaksitë e tyre, madje as emrat e gazetarëve nëpër artikuj. (Seksioni B.2)

Transmetuesi publik, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) edhe këtë vit ka funksionuar me vështirësi financiare derisa projektligji ku parashihet financimi përmes parapagimit, pritet të miratohet në Kuvend. Financimi i drejtpërdrejtë nga shteti ka bërë që RTK të jetë e ndikuar nga ndërhyrjet e politikës. Sindikata e Pavarur e RTK-së ka reaguuar disa herë, duke kritikuar menaxhmentin e transmetuesit publik për keqmenaxhimin e financave dhe punësime pa konkurs. (Seksioni B.3)

Organizata jo-profitabile mediale vazhdojnë të mabjnë nivel më të lartë të pavarësisë redaktoriale edhe pse numrin i tyre është i vogël. Pasi që kanë qëndrueshmëri financiare, këto organizata mediale kanë më shumë liri për të raportuar pa pasur frikë nga ndonjë hakmarrje politike apo ekonomike. (Seksioni B.4)

Gazetarët theksojnë se redaktorët dhe pronarët kanë tendencë që të ndikojnë në punën e tyre nëse shkrimi zbulon çështje të ndjeshme duke përfshirë interesa politike apo ekonomike. Censura përmendet në takime jo-formale nga frika që mund të humbasin punën. Gazetarët po ashtu theksojnë se kolegët e tyre e dinë paraqishtë se çfarë iu lejohet të raportojnë. (Seksioni B.5)

Treguesit C:
Siguria e gazetarëve

Sa i përket sigurisë së gazetarëve, trendi mbetet i njëjtë me vitin e kaluar. Në periudhën Janar- Shtator 2018, AGK ka regjistruar 13 raste. Është vërejtur në veçanti se, gazetarët hulumtues janë më të kërcënuarit, për shkak të hulumtimeve të tyre. Kërcënimet vijnë, që prej zyrtarëve të lartë shtetërorë e deri të qytetarët e rëndomtë. (Seksioni C.1)

Institucionet e drejtësisë dhe sigurisë kanë vazhduar me përforcimin e mekanizmave të sigurisë për gazetarët. Gjykata Themelore në Prishtinë ka iniciuar disa gjykime lidhur me rastet e kërcënimeve, shpifjeve dhe fyerjeve. AGK kërkon që këto institucione të jenë më efikase në trajtimin e rasteve të gazetarëve, duke kërkuar që lëndët të procedohen brenda afateve ligjore. (Seksioni C.2)

Sistemi penal dhe i drejtësisë kaën përmirësuar mekanizmat e tyre për mbrojtjen e gazetarëve dhe profesionistëve tjerë medial. Megjithatë, është e nevojshme një trajtim më efikas nga ana e policisë për rastet e kërcënimeve dhe sulmeve dhe prokuroria dhe gjykatat duhen të bëjnë më shumë për të mbyllur rastet me kohë. Perceptimi i gazetarëve mbetet se nxitësit e vërtetë të krimeve ndaj tyre nuk zbulohen kurrë. (Seksioni C.3)

Pasqyrë e treguesve: Për nivelin e lirisë së medie dhe sigurisë së gazetarëve në ballkanin perëndimor

A

Mbrojtja Ligjore e Lirisë së Medieve dhe Gazetarëve

A.1 A ofron legjislacioni vendor garanca për lirinë e medieve dhe a është duke u zbatuar efektivisht në praktikë? (Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Nëse e drejta e lirisë së shprehjes dhe informimit është e garantuar? A përfshijnë edhe qasjen në internet? A janë zbatuar këto garanci ligjore në praktikë?	E drejta e lirisë së shprehjes është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje të medieve, duke përfshirë qasjen në internet. Disa ligje duhen të përmirësohen (ligji kundër shpifjes, Ligji për Qasjen në Informata, Ligji i Komunikimit). Garancitë ligjore nuk janë mjaftueshëm të zbatuara në praktikë.	E drejta e lirisë së shprehjes është e garantuar me Kushtetutë dhe me ligje të medieve, duke përfshirë qasjen në internet. Nuk ekziston një ligj i veçantë që rregullon sektorin online. Disa dispozita ligjore duhen të përmirësohen (Ligji për Audio dhe Shërbimet e Medieve Audiovizuale. Garancitë ligjore nuk janë mjaftueshëm të zbatuara në praktikë.	E drejta e lirisë së shprehjes është e garantuar me Kushtetutë dhe me një varg ligjesh të medieve, duke përfshirë qasjen në internet. Nuk ekziston një ligj i veçantë që rregullon sektorin online. Prej se disa nga ligjet për medie janë të vjetërsuara, aktualisht është në process të ndryshimit Ligji për Medie, Ligji për RTCG-në. Garancitë ligjore nuk zbatohen efektivisht në praktikë.	E drejta e lirisë së shprehjes është e garantuar me Kushtetutë dhe me një varg ligjesh të medieve, duke përfshirë qasjen në internet. Nuk ekziston një ligj i veçantë që rregullon sektorin online. Garancitë ligjore janë dobët të zbatuara në praktikë.	E drejta e lirisë së shprehjes është e garantuar me Kushtetutë dhe me një varg ligjesh të medieve, duke përfshirë qasjen në internet. Nuk ekziston një ligj i veçantë që rregullon sektorin online. Garancitë ligjore nuk janë mjaftueshëm të zbatuara në praktikë. N përgjithësi, liria e medieve është në një nivel të ulët.

**A.1 A ofron legjislacioni vendor garanca për lirinë e medieve dhe a është duke u zbatuar efektivisht në praktikë?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Nëse legjislacioni i mediave është zhvilluar në mënyrë transparente dhe përfshirëse?	Perceptimi i përgjithshëm është se procesi ka qenë transparent, por shumë i ngadaltë. Ligjet aktuale kanë mbetur prapa zhvillimeve teknologjike	Në periudhën raportuese, projekt ndryshimet e Ligjit për Shërbimet e Medieve Audio dhe Audiovizuale janë dorëzuar në Parlament. Procesi ishte transparent dhe përfshirës.	Procesi i ndryshimit të Ligjit për Media, Ligji për RTCG-në ishte transparent dhe përfshirëse, dispozitat e propozuara me qëllim mbrojtjen e gazetarëve nga ndikimi i pronarëve nuk ishin pranuar në tekstin final të draftit.	Më 2017, disa ndryshime në projektligjin për RTK-në ishin debatuar me dyer të mbyllura nga ana e komisionit parlamentar për medie. Procesin nuk ka qenë as transparent as përfshirës.	Procesi ishte transparent dhe përfshirës deri në një masë, sepse asociacionet relevante të gazetarëve ishin të përfshira. Strategjia e re e medieve është në draftim e sipër dhe ndryshimet për legjislacionin e medieve ishin paralajmëruar.
A kanë tentuar autoritetet shtetërore të kufizojnë të drejtën për qasje në internet apo kanë kërkuar të bllokohen apo filtrohen përmbajtjet e internetit?	Nuk janë regjistruar raste të tilla.	Nuk janë regjistruar raste të tilla.	Nuk janë regjistruar raste të tilla.	Komisioni parlamentar për medie ka propozuar adoptimin e një Ligji të ri për Media, me qëllimin, ndër të tjera, 'disiplinimin e portaleve'. Iniciativa ishte kritikuar nga AGK dhe akterët tjerë si një përpjekje për të kontrolluar sektorin e medieve online.	Në periudhën raportuese, Share Foundation ka regjistruar 7 raste të bllokimit apo kufizimit të përmbajtjes në Internet. Nuk ka asnjë dëshmi që autoritetet shtetërore kanë bërë përpjekje për të dhunuar lirinë e shprehjes në internet.
A është autoriteti i rregullatorit duke kryer misionin dhe funksionin e saj në një mënyrë të pavarur dhe jo diskriminuese?	Rregullatori nuk perceptohet nga gazetaret si trup i pavarur dhe jo-diskriminues, sepse politikanët në pushtet ndikojnë drejtpërdrejt në emërimin e individëve në pozitat e larta në rregullator.	Ka pasur përmirësime në të kaluarën sa i përket efikasitetit të rregullatorit, por ende nuk është perceptuar si i pavarur nga politikanët.	Formalisht, pavarësia e rregullatorit është e garantuar, por është e nevojshme për të rritur po ashtu fuqitë e tij, duke përfshirë fuqinë për të vendosur sanksione. Largimi i një anëtarit të Këshillit ishte një provë e ndikimit të drejtpërdrejtë të politikës në rregullator.	Rregullatori nuk perceptohet si i pavarur. Emërimi i anëtarëve është politikisht i motivuar.	Rregullatori nuk është mjaftueshëm si i pavarur dhe transparent dhe nuk i shfrytëzon kompetencat e saja ligjore. Këshilli është politikisht i ndikuar dhe ende punon me përbërje jo të plotë.
A ekziston një praktikë e reklamimit nga shteti në media dhe a keqpërdoret për ndikime politike në politikën redaktuese?	Reklama shtetërore në media nuk është e rregulluar në mënyrë adekuate me ligj. Ka ndikim të madh në politikëkn redaktoriale të medieve të cilat pranojnë para nga buxheti. Rreth 30 milionë euro në vit janë shpenzuar nga institucione të ndryshme për reklama nëpër medie.	Qeveria e re ka ndaluar praktikën e reklamave shtetërore në vitin 2017. Sidoqoftë, në nivel lokal, komunat ende ndajnë shuma të dukshme të parave nga buxheti i komunave nëpër medie lokale. Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë kanë tërhequr vëmendjen se kjo praktikë minon gazetarinë profesionale dhe shkel pavarësinë e medieve lokale.	Ekziston një perceptim i përgjithshëm se praktika e reklamave shtetërore hap një hapësirë të madhe për abuzime dhe përdoret si një mjet për mbështetjen financiare të mediave të lidhura me Qeverinë.	Institucionet publike ndajnë para për mediet online në mënyrë selektive dhe jo-transparente. Banerët e publikuar nëpër portale të lajmeve nuk paraqesin ndonjë aktivitet të veçantë të ministrive.	Reklamat shtetërore nuk është e rregulluar në mënyrë adekuate me ligj. Kështu që, ndarja e fondeve është shpesh selektive dhe jo-transparente. Është një prej mekanizmave më kryesore për presion ndaj medieve dhe politikave të tyre redaktuese.

**A.1 A ofron legjislacioni vendor garanca për lirinë e medieve dhe a është duke u zbatuar efektivisht në praktikë?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A ekziston ndonjë lloj i subvencioneve për media apo për prodhim të përmbajtjes mediale për interes publik dhe si po zbatohet në praktikë?	Nuk ka subvencione për medie.	Për momentin, nuk ekziston ndonjë skemë e fondeve për të inkurajuar prodhimin e përmbajtjeve për interesin publik. Ekziston një iniciativë për të prezantuar subvencione për mediet e shkruara dhe mediet në gjuhët e minoriteteve.	Për momentin, nuk ekziston subvencione për medie.	Ekzistojnë fonde nga Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të zyrës së Kryeministrit, por thirrja e sivjeme nuk ka për qëllime mediet por vetëm organizatat jo-qeveritare.	Ekziston një skemë e fondeve me qëllim të inkurajimit të prodhimit të programeve në interes të publikut në mediet elektronike, të shtypura dhe online. Ka shumë mospërputhje në zbatimin e tij: disa programe të financuara nuk kanë interes publik, mungesë të procedurave të vlerësimit, abuzimi dhe keqpërdorimi i ligjit etj. Mediat që shkelin rregullat etike po ashtu fitojnë fonde.
Cilët janë mekanizmat e financimit të medieve në gjuhët e minoriteteve kombëtare?	Mekanizma të tillë nuk ekzistojnë. Minoritetet kombëtare dhe grupet e rrezikuara janë të pakënaqura me programete prodhuara në shërbimet e transmetuesit publik që kanë për qëllim veçanërisht këto grupe.	Nuk ekzistojnë mekanizma për përkrahje financiare të diversitetit të gjuhëve në mediet private. Transmetuesi publik (MRT) transmeton programe në radio dhe TV në gjuhët e 6 komuniteteve etnike jo-shumicë.	Mediet e pakicave kombëtare mbështeten financiarisht vetëm përmes Fondit për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të pakicave. Megjithatë, thirrja e fundit u botua në gjysmën e parë të vitit 2017.	Nuk ekziston asnjë mekanizëm për financimin e medias private në gjuhët e pakicave kombëtare. Transmetuesi publik (RTK) transmeton programe në të gjitha gjuhët e pakicave (serbisht, boshnjakisht, turqisht dhe në gjuhën rome). Pakica serbe ka kanalën e saj në RTK2 që nga qershori 2013.	Ekziston një skemë financimi e siguruar nga buxheti shtetëror dhe komunal. Megjithatë, mediat në gjuhët e pakicave janë ende të paqëndrueshme financiare, sepse nuk ka mekanizëm për të financuar programe informative në gjuhë të ndryshme.
A është autonomia dhe pavarësia e transmetuesit publik e garantuar dhe a po mbrohet në mënyrë efikase? A ofron korniza financiare funksionim të pavarur dhe stabil? A përfaqësojnë trupat mbikqyrëse shoqërinë e gjerë?	Autonomia dhe pavarësia garantohen me ligj. Ende nuk ka kornizë të përshtatshme të financimit për shërbimet publike në BeH. Ka indikacione se politikanët ndikojnë në masë të madhe në emërimin e redaktorëve dhe menaxhimin e shërbimeve publike. Organet mbikëqyrëse nuk përfaqësojnë shoqërinë e gjerë.	Autonomia dhe pavarësia janë të garantuara, por nuk zbatohen. Korniza e financimit nuk siguron funksionim të qëndrueshëm. Këshilli i MRT-së nuk përfaqëson shoqërinë në përgjithësi.	Autonomia dhe pavarësia janë të garantuara, por është dëmtuar seriozisht me shkarkimin e dy anëtarëve të Këshillit të RTCG-së dhe të Presidentit të tij Gjuroviq (i cili mbetet në Këshill si anëtar) ndryshimi i gjithë menaxhmentit dhe ekipit editorial. Prandaj, organi mbikëqyrës aktualisht është i ndikuar politikisht dhe përfaqëson shoqërinë në përgjithësi. Korniza e financimit u përmirësua - Qeveria do të sigurojë 40 milionë euro për operacionet e RTCG-së në tre vitet e ardhshme.	Autonomia dhe pavarësia e RTK-së është e garantuar, por dobët e zbatuar. Financimi i drejtpërdrejtë nga Buxheti nuk siguron funksionim të qëndrueshëm dhe të pavarur të RTK-së. Projektligji i ri për RTK-në parasheh një model të ri financimi të përzier: pagesa e mbledhur përmes faturave të energjisë elektrike prej 2.5 euro dhe 0.4 përqind nga Buxheti i Shtetit. Organi mbikëqyrës përfaqëson shoqërinë, por është e politizuar.	Autonomia dhe pavarësia janë të garantuara ligjërisht. Sidoqoftë, transmetuesit publik nuk janë financiarisht të pavarura, sepse kuadri i financimit nuk siguron funksionimin e tyre të qëndrueshëm. Këshilli i Programit nuk kontrollohet nga shoqëria, sepse politikanët në pushtet ndikojnë në emërimin e anëtarëve të saj. Ajo ka vetëm një funksion këshillëdhënës.

**A.2 A është dekurajues ligji për shpifje në mesin e gazetarëve?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A janë dispozitat e ligjit kundër shpifjes tepër të rënda apo mbrojtëse në përfitim për zyrtarët shtetërorë?	Shpifja është dekriminalizuar para 20 viteve. Legislacioni aktual është në vijë me standardet Europiane – dispozitat nuk janë mbrojtëse në të mirë të zyrtarëve.	Shpifja u dekriminalizua në vitin 2012. Është vendosur Ligji për Përgjegjësinë Civile. Ligji po zbatohet dhe dispozitat e tij nuk janë kufizuese për gazetarët.	Shpifja është dekriminalizuar. Ekziston një perceptim i përgjithshëm se është më e lehtë të padisëh se sa të mbrohesh nga një padi për dëmtimin e nderit ose të reputacionit të dikujt. Zyrtarët publikë nuk tregojnë një nivel më të lartë të tolerancës ndaj kritikave, dhe ky standard nuk kuptohet madje as nga gjykatat.	Shpifja është dekriminalizuar. Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nuk ka dispozita që janë tepër mbrojtëse në të mirë të zyrtarëve shtetëror.	Shpifja është dekriminalizuar, por kjo nuk ka përmirësuar situatën e gazetarëve. Numri i padive për dëmet jo-materiale është ende shumë i madh, dhe në disa raste gjobat janë shumë të mëdha.
Sa padi janë inicuar kundër gazetarëve nga zyrtarët shtetërorë në tre vitet e fundit?	Një numër i madh i padive janë paraqitur nga politikanët kundër gazetarëve (më shumë se 100 në vit). Kjo krijon një ndjenjë shumë të fortë frike dhe censure automatike, veçanërisht në mesin e gazetarëve në mediat lokale.	Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Maqedonisë, në periudhën raportuese, rreth 35 padi të reja janë ngritur kundër gazetarëve. Kjo shifër është dhjetë herë më e vogël se në vitin 2012.	Nga viti 2011 deri në qershor 2017, kishte 109 raste për shpifje apo fyerje në gjykata. Në këto raste, nga media u kërkuan më shumë se një milion euro, ndërsa në 24 raste të miratuara, mediat duhej të paguanin 45,300.00 euro.	Asnjë padi nuk është inicuar kundër gazetarëve në periudhën raportuese. Sipas regjistrat të gjykatës, ka pasur 59 padi për shpifje dhe fyerje që nga viti 2009. Nga këto 59 raste, 10 janë parashtruar nga zyrtarët shtetërorë, dhe shumica prej tyre ishin figura të larta.	Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e padive të paraqitura nga zyrtarët publikë. Numri i përgjithshëm i padive të paraqitura në periudhën raportuese kundër gazetarëve është 650. Numri i të gjitha padive të pazgjidhura (duke përfshirë ato nga vitet e kaluara) është 1011.
A ka shembuj kur dispozita tjera ligjore janë përdorur për të "heshtur" gazetarët për kritikë legjitime apo për gazetari hulmuese?	Kundër një gazetari të përditshmes Oslobodenje 105 padi janë paraqitur. Revista Slobodna Bosna pushoi botimin e gazetës së saj më 2015, nën presionin e një numri të madh të padive për shpifje.	Nuk janë regjistruar rastë të tilla.	Nuk janë regjistruar rastë të tilla. Megjithatë, ekziston një perceptim se numri i madh i padive, gjobat e mëdha dhe niveli i ulët i tolerancës ndaj zyrtarëve publikë ndaj kritikave kontribuojnë në efektin e frikjes midis gazetarëve.	Nuk janë regjistruar rastë të tilla.	Nuk janë regjistruar rastë të tilla.
A është drejtësia e administruar në atë mënyrë që është politikisht e motivuar kundër disa gazetarëve? Çfarë dënime janë dhënë?	Gjykatat janë nën ndikim të fortë politik. Gjykata Themelore në Banja Luka kishte disa vendime të diskutueshme në favor të disa politikanëve që paditën mediat apo gazetaret individualisht për shpifje.	Gjopa të mëdha u janë shqiptuar gazetarëve ose mediave në disa padi të paraqitura nga zyrtarë të lartë të partisë në pushtet Bashkimi Demokratik për Integrimin. Ekziston një perceptim se këto vendime janë ndikuar politikisht.	Nuk janë regjistruar rastë të tilla.	Kishte raste të izoluar kur gjyqtarët ishin të motivuar politikisht. Për shembull, në rastin e një gazetari që ishte sulmuar fizikisht, gjykata vendosi një dënim me kusht prej katër muaj për kryerësin e veprës.	Ekziston një perceptim se në disa raste, vendimet e gjykatave janë ndikuar politikisht. - Ministri i Brendshëm kundër magazines javore NIN dhe Ministri i Brendshëm kundër portalit Pescanik.
A i njohin gjykatat mekanizmat vetë-rregullues (nëse ka)? A e pranojnë vlefshmërinë e një përgjigje, korigjim ose kërkim falje të publikuar?	Gjykatat e njohin vlefshmërinë e një korigjimi, përgjigjeje ose kërkim falje të publikuar kur vendosin për dëmin jomaterial.	Gjykata mund të marrë parasysh vendimet e Këshillit të Etikës së Medias, megjithatë kjo nuk është e detyrueshme.	Gjykatat nuk janë të detyruara të marrin në konsideratë vendimet e marra nga vetë-rregullatori.	Gjykatat nuk marrin gjithmonë parasysh vendimet e organit vetë-rregullues.	Gjykatat nuk janë të detyruara të marrin në konsideratë vendimet e organit vetë-rregullues. Avokatët zakonisht paraqesin vendimet e Këshillit të Shtypit kur shkelet Kodi i Etikës.

**A.2 A është dekurajues ligji për shpifje në mesin e gazetarëve?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Çfarë mendojnë gazetarët për ligjin kundër shpifjes? A janë të dekurajuar për të hulumtuar dhe të kritikojnë me shkrime?	Paditë për shpifje perceptohen nga gazetarët si një mjet i madh presioni, veçanërisht për gazetarët nga komunitetet më të vogla lokale. Shumë media nuk janë as financiarisht të aftë për të marrë pjesë në procedurat gjyqësore.	Vetëm një numër i vogël gazetarësh mendojnë se kërcënimi për shpifje ndikon në punën e tyre.	Në anketën e kryer në vitin 2018, rreth 49% e gazetarëve u përgjigjën se kërcënimi për shpifje ka shumë ndikim ose ndikim të jashtëzakonshëm në punën e tyre.	Gazetarët në përgjithësi nuk janë të dekurajuar për të hulumtuar dhe për të shkruar në mënyrë kritike.	Gazetarët kanë mendime të ndryshme kur është fjala për ndikimin negativ të padive shpifëse në punën e tyre. Në sondazhin e mëparshëm, 26% e gazetarëve thanë se kërcënimi për shpifje ka shumë ndikim ose jashtëzakonisht ndikues në punën e tyre.

**A.3 A ka mbrojtje ligjore të mjaftueshme të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatës zgjedhore?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A është pluralizmi politik në media i rregulluar në legjislacionin për media (për periudhën jo-zgjedhore)?	Ekziston vetëm një parim i përgjithshëm për transmetuesit që të pasqyrojnë pikëpamjet politike dhe burimet e informacionit.	Nuk ka dispozita specifike për mbrojtjen e pluralizmit politik në periudhën jo-zgjedhore. Ekziston vetëm një parim i përgjithshëm për transmetuesit që të pasqyrojnë pikëpamjet e ndryshme politike dhe të raportojnë në një mënyrë të balancuar dhe objektive.	Për periudhën jo-zgjedhore, ka vetëm një parim të përgjithshëm për transmetuesit që të pasqyrojnë pikëpamjet e ndryshme politike. Amendamentet e Ligjit për Media Elektronike përcaktojnë rregullat për mbulimin e medias gjatë fushatave zgjedhore dhe reklamave politike.	Ekziston vetëm një parim i përgjithshëm për transmetuesit që të reflektojnë pikëpamjet e ndryshme politike.	Pluralizmi politik për periudhën jo-zgjedhore është e garantuar vetëm në Ligjin për Shërbimet Publike të Medias.
A është autoriteti i rregullatorit i obliguar që të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik?	Sipas Ligjit për komunikimet e BiH, parimet rregullatore të transmetimit përfshijnë mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe diversitetin e opinionit. Rrjedhimisht, Agjencia Rregullatore e Komunikimit është e obliguar që të monitorojë zbatimin e këtyre parimeve rregullatore gjatë periudhave zgjedhore dhe jo zgjedhore.	Rregullatori është i detyruar të monitorojë mediat audiovizuele vetëm në periudhën e zgjedhjeve. Ajo gjithashtu ka fuqinë të vendosë sanksione mbi mediat jo-pajtuese dhe në vitin e kaluar ka rritur vendimet e saj për ta bërë këtë.	Dispozitat e reja të miratuara të Ligjit për media elektronike detyrojnë rregullatorin të ndalojë kodet e sjelljes së transmetuesve gjatë fushatave zgjedhore. Gjatë zgjedhjeve të fundit, rregullatori bëri monitorimin e mbulimit mediatic të zgjedhjeve.	Rregullatori është i detyruar me ligj vetëm për periudhën e fushatës zgjedhore.	Ligji për mediat elektronike parashikon detyrimin e rregullatorit për të mbrojtur pluralizmin politik në media gjatë fushatës zgjedhore. Megjithatë, rregullatori nuk ka monitoruar mediat gjatë zgjedhjeve presidenciale në 2017 dhe zgjedhjet lokale të Beogradit në 2018.
Cilat janë obligimet ligjore për media gjatë fushatës zgjedhore?	Ligji Zgjedhor përcakton parimet e pluralizmit për të gjitha mediat. Ligji për komunikim përcakton parimet e përgjithshme të transmetimit, të cilat përfshijnë edhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe diversitetin e opinionëve, drejtësisë, saktësisë dhe paanësisë.	Kodi zgjedhor dhe aktet nënligjore i përshkruajnë rregullat për qasje të drejtë dhe të barabartë në të gjitha partitë politike, raportim objektiv, të drejtë dhe të balancuar etj.	Kodi Zgjedhor parashikon detyrime për median për të siguruar qasje të drejtë dhe të barabartë në të gjitha partitë politike dhe kandidatët dhe të raportojë në mënyrë objektive, të drejtë dhe të balancuar.	Mediat janë të detyruara sipas Ligjit Zgjedhor dhe Kodit të Sjelljes për Komisionin e Pavarur të Mediave të paraqesin qasje të drejtë dhe të barabartë në të gjitha partitë politike, raportim objektiv, të drejtë dhe të balancuar.	Ligji për mediat elektronike dhe Ligji për shërbimet publike të medias parashohin rregullat për paraqitjen e drejtë dhe të balancuar të partive politike, koalicioneve dhe kandidatëve. Rregullatori miraton Rregulloren për obligimet e ofruesve të shërbimeve mediale gjatë fushatave zgjedhore.

**A.3 A ka mbrojtje ligjore të mjaftueshme të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatës zgjedhore?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë periudhës jo-zgjedhore dhe gjatë fushatave zgjedhore?	Partitë politike nuk kanë qasje të drejtë dhe të barabartë në media, veçanërisht në periudhën e zgjedhjeve.	Sipas raportit të OSBE-së, gjatë zgjedhjeve komunale në tetor 2017 ka pasur një përmirësim të qasjes së shumëllojshmërisë së qëndrimeve politike në media - në krahasim me zgjedhjet e mëparshme.	Ekziston një praktikë e dukshme e anshmërisë politike dhe qasjes së pabarabartë në media për aktorët politikë. Shkelja e vazhdueshme e qasjes së barabartë në parimet e medias ishte e dukshme gjatë zgjedhjeve presidenciale të prillit 2018, siç ishte e dukshme në ciklet e mëparshme elektorale.	Partitë politike në përgjithësi marrin qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë fushatave jo-zgjedhore dhe zgjedhore.	Partitë politike nuk kanë qasje të drejtë dhe të barabartë në media edhe gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe gjatë periudhës jo-zgjedhore.

**A.4 A është e garantuar liria dhe asociimi i gazetarëve dhe a po zbatohet në praktikë?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A duhen gazetarët që të liçensohen nga shteti para se ata t nisin punën?	Gazetarët nuk kërkohen nga ligji për të pasur një licencë për të kryer punën e tyre. Nuk ka përkufizim ligjor të nocionit 'gazetar'	Gazetarët nuk kanë nevojë për licencë nga asnjë autoritet shtetëror, por Ligji për Media përmban një definicion kufizues të një 'gazetari'. Kishte nisma për të futur 'licenca' për gazetarët, por ato nuk u pranuan nga Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë.	Gazetarët nuk kanë nevojë për licencë nga asnjë autoritet shtetëror. Varet nga redaksitë se kush do të angazhohet si gazetar.	Gazetarët nuk kanë nevojë për licencë nga asnjë autoritet shtetëror për të filluar punën në media.	Gazetarët nuk kanë nevojë për licencë nga asnjë autoritet shtetëror.
A kanë qenë gazetarët të refuzuar të raportojnë nga ngjarje të caktuara?	Në janar 2017, gazetarët nga N1 TV u ndaluan të raportonin nga Pallati i Republikës Srpska. Ekuipazhi i mediave të Miqtë e Srebrenicës ishte e ndaluar të raportojë nga Qendra Përkujtimore në Potočari.	Raste të tilla nuk janë regjistruar në periudhën raportuese.	Çdo i katërti gazetar nuk u lejua të raportonte nga një ngjarje sepse ata nuk kishin akreditim. Kishte disa raste serioze: gazetarët e portalit të lajmeve Fos Media u ndaluan të raportonin nga selia e Koalicionit për Shekullin 21 gjatë zgjedhjeve lokale në maj 2018.	Një institucion publik pushoi së komunikuari me një gazetare dhe zhvilloi një fushatë të rëndë kundër gazetares. AGK reagoi dhe institucioni publik ndërpreu fushatën.	Trendi i mos ftesës ose pengimit të disa gazetarëve nga raportimi i ngjarjeve të caktuara nga autoritetet politike vazhdoi në vitin 2018. Janë 13 raste në bazën e të dhënave të NUNS.

**A.4 A është e garantuar liria dhe asociimi i gazetarëve dhe a po zbatohet në praktikë?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A janë dhe si janë gazetarët të organizuar në asociacione profesionale? A ekzistojnë presione në asociacionin e tyre apo anëtarëve individual?	Rreth 50% e gazetarëve janë anëtarë të një prej 5 shoqatave të regjistruara; Asociacioni i Gazetarëve të BeH-së ishte subjekt i presioneve politike dhe sulmeve verbale. Në mars të vitit 2018 anëtar i i një këshilli bashkiak kërcënoi Sekretariatit e Asociacionit të Gazetarëve të BeH me padri gjyqësore.	Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë (AJM) është më e vjetra (që nga viti 1946) dhe shoqata më e madhe, anëtare e IFJ-së. Asociacioni i Gazetarëve Maqedonas (MAN), e cila ka qenë aktive që nga viti 2013, konsiderohet si afër partisë opozitare VMRO-DPMNE.	Ekzistojnë tri asociacione të gazetarëve. Gazetarët kanë më shumë liri për të qenë pjesë e një shoqate, por vetëm 23% janë të gatshëm të bashkohen, sepse ata mendojnë se asociacionet nuk mund t'i mbrojnë të drejtat e tyre. Presionet mbi asociacionet ose udhëheqësit e tyre nuk janë regjistruar.	Gazetarët janë të lirë të bashkohen me asociacionet profesionale. Nuk ka dëshmi të presionit. Në Kosovë ekzistojnë dy asociacione të gazetarëve, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Asociacioni i Gazetarëve Serb të Kosovës, me anëtarë kryesisht nga komuniteti serb.	Jo shumë gazetarë janë anëtarë të asociacioneve të gazetarëve. Ekzistojnë dy asociacione kryesore: Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Serbisë (NUNS) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Serbisë (UNS). Të tjerët janë rajonalë, ku Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Vojvodinës (NDNV) është më aktive. Asociacionet janë nën presione të vazhdueshme, sidomos kur janë kritike ndaj politikaneve në pushtet në rastet e shkeljeve të lirive të mediave.
A janë dhe si janë të organizuar gazetarët në sindikata? A ka presione ndaj udhëheqësve të sindikatave dhe anëtarëve tjerë?	Ekzistojnë sindikata brenda transmetuesve publik. Në transmetuesin publik në nivel shtetëror (BHRT) dy sindikata janë aktive. Ekzistojnë gjithashtu: Bashkimi i botimeve grafike dhe punonjësve të medias dhe Bashkimi i mediave dhe punëtorëve grafik Republika Srpska. Disa prej tyre raportojnë presione. Nuk ka asnjë sindikatë të gazetarëve në nivel shtetëror.	Ekziston Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve të Mediave, e themeluar në vitin 2010.	Ekzistojnë dy organizata: Sindikata e Mediave të Malit të Zi dhe Sindikata e sektorit informativ, grafik dhe botues. Ata kanë nënshkruar një marrëveshje për aktivitete të përbashkëta. Rreth 50% e të punësuarve në media janë anëtarë të Sindikatës së Mediave të Malit të Zi, duke përfshirë 270 punonjës në shërbimin publik. Presionet e drejtpërdrejta mbi shoqatat apo drejtuesit e tyre nuk janë regjistruar.	Nuk ka asnjë sindikatë që përfaqëson interesat e të gjithë gazetarëve në Kosovë.	Vetëm një numër i vogël gazetarësh janë anëtarë të Sindikatave, të cilat janë të dobëta dhe nën presione të vazhdueshme. Nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje kolektive për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të gazetarëve.
A janë gazetarët të lirë të bëhen anëtarë të sindikatave? Sa gazetarë janë anëtarë të sindikatave?	Nuk ka të dhëna të sakta për anëtarësimin e sindikatave. Asociacioni i Gazetarëve të BeH raporton mbi kufizimet për gazetarët dhe profesionistët e medias për t'u organizuar në sindikatat. Vlerësohet se vetëm 16% e mediave private kanë krijuar degë të sindikatave.	Ekziston një sindikatë në transmetuesin publik. Pothuajse asnjë sindikatë në mediat private. Nuk ka shifra të besueshme rreth anëtarësimit, sepse disa anëtarë janë "të fshehur" për shkak të frikës nga presionet.	Sipas anketës, çdo i pesti gazetar nuk është i lirë të jetë pjesë e sindikatës, por madje 38% e të anketuarve deklaruan se janë anëtarë të një sindikate. Disa gazetarë dëshmojnë për kërcënimet nëse hyjnë në një sindikatë.	Transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka dy sindikata. Më herët kishte presione para drejtuesve të njërës prej sindikatave.	Shumica e gazetarëve ndihen të lirë të bëhen anëtarë, por ata nuk janë të interesuar në përgjithësi për shkak se sindikatat janë të dobëta, edhe pse ka edhe arsye të tjera.

**A.4 A është e garantuar liria dhe asociimi i gazetarëve dhe a po zbatohet në praktikë?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A ekziston ndonjë këshill shtypit dhe a ka presione në anëtarët e tij?	Këshilli i Mediave të Shkruara u themelua 18 vjet më herët dhe është i vetmi organ vetërregullues në BeH. Nuk ka presione të drejtpërdrejta politike, por në vitet e fundit ka pasur tre sulme të organizuara të hakerëve në faqen e saj të internetit.	Këshilli i etikës së mediave të Maqedonisë u themelua në vitin 2013 si një organ vetërregullues. Pothuajse të gjitha stacionet televizive kombëtare, portalet e lajmeve dhe mediat e shkruara janë anëtarë të këtij trupi.	Organi vetërregullues - Këshilli i Mediave për Vetërregullim u themelua në vitin 2012. Ajo mbledh 19 media, ndërsa disa prej mediave kryesore si Dan, Vijesti, Monitor dhe TV Vijesti kanë ombudsmenët e tyre. Nuk ka pasur presione, por Këshilli i Medias është shumë i dobët dhe për shkak të mungesës së fondeve, Komisioni i Ankesave të përkohshëm nuk funksionon.	Ekziston një Këshill i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe nuk ka dëshmi të presionit mbi anëtarët e saj.	Ekziston një Këshill i Shtypit, organ vetërregullues, i cili tregon rezultate shumë pozitive në punën e tij. Presionet e vendosura mbi këtë trup janë indirekte dhe delikate.

**A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Si garantohet besueshmëria e burimeve të gazetarëve në legjislacion?	Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në disa akte ligjore, edhe pse disa çështje duhet të përcaktohen më saktësisht.	Është e garantuar me Kushtetutë dhe në disa akte ligjore.	Është e garantuar në Kushtetutë dhe në Ligjin për Media. Projekt-amendamentet e Ligjit për Media pritet të forcojnë më tej këto dispozita, në përputhje me standardet e Këshillit të Europës.	Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar me Ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarëve që hyri në fuqi në vitin 2013.	Është e garantuar me Kushtetutën, Ligjin për Informimin Publik, Mediat dhe Kodin Penal.
A respektohet besueshmëria e burimeve të gazetarëve? A ka shembuj të urdhërave ndaj gazetarëve për të shpalosur burimin e tyre dhe a është arsyetuar ajo për të mbrojtur interesin publik?	Ajo u respektohet përgjithësisht në periudhën raportuese. Raste të reja nuk janë regjistruar.	Ajo u respektohet përgjithësisht në periudhën raportuese. Raste të reja nuk janë regjistruar.	Besueshmëria u respektohet përgjithësisht në periudhën raportuese. Megjithatë, ka pasur incidente të izoluara - në vitin 2018 autoritetet policore kanë kërkuar nga gazetarët e gazetës Vijesti, të zbulojnë burimin e tyre të informacionit në një artikull nga 2017.	Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është respektuar përgjithësisht në periudhën raportuese. Raste të reja nuk janë regjistruar.	Në përgjithësi, ajo respektohet. Nuk u regjistruan raste serioze të urdhërimit të gazetarëve për të zbuluar burimet e tyre.
A ka pasur sanksione kundër gazetarëve të cilët kanë refuzuar të tregojnë identitetin e burimit?	Raste të tilla nuk janë regjistruar.	Raste të reja nuk kjanë regjistruar.	Raste të tilla nuk janë regjistruar.	Raste të tilla nuk janë regjistruar.	Raste të tilla nuk janë regjistruar.
A ndjehen të lirë gazetarët kur kërkojnë qasje dhe të mbajnë kontakte me burimet e informacionit?	Gazetarët e intervistuar zakonisht janë të lirë të zgjedhin burimet e tyre dhe kanë tendencë të mbajnë komunikim të qëndrueshëm me ta.	Sipas gazetarëve të intervistuar, ata ndjehen të lirë të mbajnë kontakte me burimet e tyre të informacionit.	Pothuajse 57% e gazetarëve në anketë kanë deklaruar se ata rregullisht ose shumë shpesh kanë kontakte me burimet e tyre.	Gazetarët pretendojnë të ndihen të lirë të mbajnë kontakte me burime informacioni.	Mendimet e gazetarëve janë të ndara. Një problem është theksuar se si gazetari mund të mbrojë anonimitetin në burim, në rast të përgjimit të komunikimeve.

**A.6 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore në të drejtën për qasje në informacion?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Cilat janë rregullat ligjore për qasje në dokumente zyrtare dhe informacione të cilat janë relevante për gazetarët?	Qasja është e garantuar me ligjet në nivel shtetëror dhe të entiteteve. Nuk ka dispozita specifike që kanë të bëjnë vetëm me gazetarët.	Qasja është e garantuar me ligj. Nuk ka dispozita specifike relevante për gazetarët. Zbatimi është i dobët. Në shkurt të vitit 2018, Ministria e Drejtësisë njoftoi se do të hartohen ndryshimet në Ligjin për Qasje të Lirë në Informata, por një dokument i tillë nuk është publikuar deri në fund të shtatorit 2018.	Qasja është e garantuar me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata. Ndryshimet në Ligjin për Qasje të Lirë në Informata, të miratuara në maj 2017, kanë vështirësuar edhe më shumë qasjen në informatat publike. Lista e informacionit në të cilën qasja mund të kufizohet nga institucionet publike (në bazë të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale) është zgjeruar.	Qasja është e garantuar. Ndryshimet në Ligjin për Qasjen në Dokumente Zyrtare të miratuara në vitin 2017 shkurtuan afatin për institucionet shtetërore për t'iu përgjigjur kërkesave për informim publik prej 15 në 7 ditë. Kjo u vlerësua nga gazetarët si një hap pozitiv për punën e tyre.	Qasja është e garantuar me ligj. Nuk ka dispozita specifike që kanë të bëjnë vetëm me gazetarët.
A i përdorin këto rregulla gazetarët? A i përfillin rregullat autoritetet pa vonesa? Sa refuzime janë raportuar nga gazetarët?	Shumë gazetarë nuk i përdorin këto dispozita ligjore, sepse afati prej 15 ditësh është shumë i gjatë. Qendra për Raportim Hulmues dorëzon mijëra kërkesa në institucionet publike, por shpesh iu mohohet qasja në dokumente publike.	Gazetarët nuk janë të informuar mirë për rregullat dhe rrallë i përdorin ato. Ata që kërkuan qasje shpesh u refuzuan.	Pothuajse çdo i treti gazetar në anketë deklaroi se kurrë nuk kishte paraqitur një kërkesë, ndërsa pothuajse i njëjti numër kishte paraqitur kërkesa por ishte refuzuar. Nga 67 kërkesa të paraqitura në vitin 2017, 13 janë refuzuar, ndërsa nga 20 kërkesa të paraqitura në vitin 2018 (deri në fund të gushtit) 8 u refuzuan.	Jo shumë gazetarë i përdorin këto rregulla. Gazetarët e intervistuar pohuan se ata janë refuzuar kur kanë kërkuar qasje në dokumente dhe informata.	Gazetarët hulumtues përdorin këtë të drejtë më shumë se ata që punojnë në raportimin ditor. Institucionet shtetërore shpesh nuk sigurojnë qasje në informata, problemi më i madh janë ndërmarrjet publike.
A janë gjykatat transparente? A ofrohet qasja e mediave në procedimet ligjore në baza jo-diskriminuuese dhe pa kufizime të panevojshme?	Mendimet e gazetarëve janë të ndara në aspektin e hapjes dhe transparencës së gjykatave. Disa gjykata nuk kanë burime për të siguruar qasje në kohë dhe për të përbushur kërkesat e transparencës.	Ekziston një perceptim i përgjithshëm midis gazetarëve se gjykatat nuk janë mjaft transparente.	Dëgjimet gjyqësore janë kryesisht të hapura për mediat. Disa seanca dëgjimore, siç është ajo në rastin e "Puçit", transmetohen direkt. Megjithatë, rreth 37% e gazetarëve kanë deklaruar se gjykatat kanë demonstruar nivel të ulët të transparencës dhe çdo i treti gazetar vlerëson gjykatat si shumë ose tërësisht transparente.	Dëgjimet gjyqësore në përgjithësi janë të hapura për mediat. Asnjë rast nuk është raportuar se qasja në procedurë është bërë në baza diskriminuuese.	Gjykatat nuk janë mjaft transparente, por kjo kryesisht varet nga personi që kryeson institucionin.
A ofrohen qasje publike në seancat e parlamentit? A ka kufizime për gazetarë për të përcjellur punën e parlamentit?	Formalisht, nuk ka kufizime për gazetarët që të raportojnë nga sesionet parlamentare. Megjithatë, në vitin 2017 një gazetar i TVN1 nuk u lejua të raportonte nga Pallati i Drejtësisë i RS. Korrespondenti i Agjencisë Beta dhe televizioni BN nga Bijeljina janë ndaluar të hyjnë në Pallatin e Drejtësisë.	Seancat e Kuvendit janë të hapura për gazetarët. Nuk pati raste të kufizimeve të regjistruara në periudhën raportuese.	Seancat parlamentare transmetohen drejtpërdrejtë në transmetuesin publik. Në anketën me gazetarët, për të tretën vit me radhë, Parlamenti u vlerësua si institucioni më transparent. 25% e të anketuarve besojnë se Parlamenti ka treguar një shkallë të lartë ose transparencë të plotë.	Në përgjithësi, seancat e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe të komisioneve parlamentare kanë qenë të hapura për publikun dhe gazetarët.	Qasja në seancat e kuvendeve në nivel kombëtar dhe lokal sigurohet kryesisht nëpërmjet transmetimeve direkte. Megjithatë, ka raste kur gazetarëve u është ndaluar të bëjnë punën e duhur (Kuvendi i qytetit të Valjevës).
Sa është e hapur qeveria dhe ministrët përkatëse?	Të gjithë gazetarët dhe ekspertët e intervistuar pajtohen se qeveria dhe ministrët nuk janë mjaft transparente.	Krahasuar me vitet e kaluara, ekziston një perceptim i përgjithshëm midis gazetarëve se qeveria ka rritur nivelin e transparencës.	50% e gazetarëve në anketë e shohin Qeverinë si pjesërisht transparente, ndërsa më shumë se 18% deklaruan se Qeveria ishte shumë ose tërësisht transparente.	Kryeministri po mban pothuajse çdo javë një konferencë shtypi, krahasuar me kryeministrin e mëparshëm që nuk kishte një praktikë të tillë. Ministrët kanë tendencë të refuzojnë t'u japin përgjigje gazetarëve kur kërkojnë informacion lidhur me raportimin e tyre.	Qeveria dhe ministrët nuk janë mjaft transparente: sesionet e organeve shtetërore në nivel kombëtar dhe lokal janë ende të mbyllura për publikun. Komunikimi me gazetarët kryesisht është zvogëluar në njoftimet për shtyp dhe konferencat për shtyp.

B

Pozita e gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

B.1 A keqpërdoret pozita ekonomike e gazetarëve për të kufizuar larine e tyre? (Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A kanë mbrojtje adekuate sociale? Sa janë pagat e larta të gazetarëve? A paguhen ata rregullisht?	Shumë gazetarë nuk janë zyrtarisht të punësuar ose kanë kontrata të punës të papërshtatshme. Ata që kanë kontrata të nënshkruara ende nuk janë të mbrojtur në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk gëzojnë të gjitha të drejtat ligjore të garantuara me ligj. Sipas një sondazhi, më shumë se 61% kanë pozita të përhershme pune. Pagat shkojnë nga 500 në 1000 BAM, por në mediet lokale pagat janë shumë më të ulëta.	Gjysma e gazetarëve fitojnë paga më pak se mesatarja kombëtare. Shumë shpesh pagat nuk paguhen rregullisht. Paga mesatare e gazetarëve është 18,800 denarë neto (rreth 300 euro) në muaj, që është rreth 30% më pak se paga mesatare në vitin 2018. Më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të gazetarëve nuk kanë nënshkruar kontrata të punës.	Nuk ka informacion për numrin e gazetarëve që kanë kontratë. Zyra e Statistikave e Malit të Zi regjistroi rënien e numrit të punëtorëve në sektorin e medias, ku aktualisht punojnë 1.350 persona. Pagat e gazetarëve janë nën mesataret shtetërore dhe më shumë se një e treta e të anketuarve marrin 400 deri në 500 euro. Pagat janë më të larta në mediat private, ndërsa të ardhurat e atyre gazetarëve që punojnë në mediat lokale vonohen dhe deri në tetë muaj.	Pasiguria ekonomike, frika e humbjes së punës, puna e nënvleftësuar, puna e papaguar jashtë orarit mbetet një problem për gazetarët në vitin 2018. Shumë nga gazetarët punojnë pa nënshkruar kurrë një kontratë pune dhe nuk kanë mbrojtje sociale.	Nuk ka të dhëna të sakta, por dihet se shumë gazetarë punojnë pa kontratë pune. Shumë pak media ofrojnë mbrojtje sociale për gazetarët. Pagat janë të ulëta dhe ka ankesa se pagat nuk paguhen rregullisht. Sondazhi i kryer në kuadër të këtij projekti dy vjet më parë, tregoi se 22,5% e gazetarëve të intervistuar thanë se paga e tyre mujore është ndërmjet 300 dhe 400 euro, 13,5% midis 200 dhe 300 euro dhe 16,2% midis 400 dhe 500 euro.

**B.1 A keqpërdoret pozita ekonomike e gazetarëve për të kufizuar larine e tyre?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Çfarë janë kushtet e punës për gazetarë? Cilat janë problemet më të mëdha që ata ballafaqohen në vendin e tyre të punës? A e shohin pozitën e tyre për të mirë apo për të keq krahasuar me periudhat e mëhershme?	Punë e pasigurtë - pagesa të parregullta, mbingarkesa e punës, puna e papaguar jashtë orarit, frikësohen se do të humbnin vendet e punës. Sipas Linjës së Lirë në vitin 2018 ka një rritje të rasteve të të drejtave të punëtorëve të gazetarëve që janë shkelur.	Marrëveshjet kolektive të punës nuk janë nënshkruar me menaxhimin e mediave private, gjë që rrezikon sigurinë shoqërore të këtyre profesionistëve. Kërcënimi i humbjes së punës është i vazhdueshëm dhe kjo nuk është ndryshuar gjatë dy viteve të fundit.	Mbingarkesa e punës, puna e pakontraktuar dhe puna jashtë orarit janë problemet më të shpeshta. 63% e gazetarëve të përfshirë në një sondazh të kryer për qëllimet e këtij projekti kanë deklaruar se në vitet e fundit koha e tyre e shpenzuar për punë është rritur. Rreth 60% pretendojnë se gjendja ekonomike e gazetarëve është përkeqësuar. Pothuajse 15% e të anketuarve duhet të punojnë një punë shtesë për jetesë. Senzacionalizmi dhe fitimi i profitit kanë shtuar presion shtesë ndaj profesionistëve.	Puna e pasigurtë është ende një problem për gazetarët kosovarë. Ata punojnë jashtë orarit ose gjatë pushimeve pa kompensime. Gazetarët pohojnë se pozicioni i tyre është më i keq në krahasim me vitin e kaluar.	Gazetarët në Serbi kanë punuar në kushte të vështira shumë kohë të gjatë. Ata janë nën presione të vazhdueshme, si jashtë dhe brenda redaksisë. Siguria sociale e tyre është në rrezik, për shkak të sindikatave të dobëta.

**B.2 Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale nga pronarët e medieve dhe trupave menaxhuese?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Sa media kanë struktura të brendshme organizative që mbajnë redaksitë të ndara dhe të pavarura nga menaxherët dhe departamenti i marketingut?	Redaksitë në mediet private vazhdojnë të jenë të varura nga menaxherët dhe sektorët e marketingut. Shumica e medieve private nuk kanë struktura të tilla të brendshme organizative.	Vetëm mediet më të mëdha mbajnë redaksitë e tyre të ndara nga sektorët e menaxhimit. Sidoqoftë, redaksitë zakonisht janë nën një ndikim të fortë nga sektorët e menaxhimit dhe marketingut, si dhe nga interesat politike.	Nuk ka informata nëse disa nga mediet kanë miratuar rregulla të tilla. Në të kaluarën ka pasur raste kur mediet nuk kanë lejuar artikuj kritik të reklamuesit.	Mediet më të mëdha i mbajnë redaksitë të ndara, por ato ende ndikohen nga menaxherët dhe pronarët.	Shumica e medieve private nuk kanë struktura të brendshme të vendeve të punës, por mungojnë edhe akte të tjera ligjore që do të siguronin pavarësinë e redaksive nga departamentet e tjera.
A kanë vendosur rregulla mediat private për pavarësinë editoriale nga pronarët e mediave dhe trupave menaxhuese? A respektohen këto rregulla?	Rregullat e brendshme janë miratuar vetëm nga mediat kryesore rajonale, si N1 dhe Al Jazeera. Nuk ka autonomi profesionale në mediet private. Problemi kryesor është se vetë gazetarët zakonisht hezitojnë të shkruajnë artikuj kritikë reth kompanive që reklamojnë në mediet ku ata punojnë, sepse kështu medite do të humbnin burimet e fondeve, dhe rrjedhimisht gazetarët do të humbnin pagat e tyre.	Situata në këtë drejtim mbetet e pandryshuar në krahasim me vlerësimin e vitit 2016 - shumë pak media kanë shkruar rregullat e pavarësisë editoriale të brendshme. Pavarësia editoriale nga pronarët e medieve dhe organet drejtuese përgjithësisht është komprometuar në shumicën e mediave në Maqedoni.	Propozimi i Sindikatës së Medieve të Malit të Zi për të siguruar pavarësinë editoriale në media në këtë vend duke ruajtur redaksitë nga interesa biznesi nuk është përfshirë në projektligjin për median. Propozimi u bazua në rekomandimet e Këshillit të Evropës.	Shumë pak media kanë rregulla të tilla. Megjithatë, pavarësia editoriale e mediave në Kosovë nga presionet ekonomike dhe politike vazhdon të rrezikohet.	Pothuajse asnjë prej medieve private në Serbi nuk ka miratuar rregulla të brendshme për ruajtjen e pavarësisë së politikës së tyre editoriale nga pronarët dhe organet drejtuese. Shembulli i vetëm i njohur është portali i lajmeve Južne Vesti. Vetëm 12 media kanë pranuar të nënshkruajnë anekset e kontratave të punës (të shkruara nga avokatët e NUNS) me qëllim të rritjes së statusit ligjor dhe profesional të gazetarëve.

B.2 Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale nga pronarët e mediave dhe trupave menaxhuese? (Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A i kanë adoptuar redaksitë e mediave private kodet e brendshme të etikës apo i përfillin kodit të përgjithshëm të etikës?	Shumica e mediave private nuk e kanë kodin e brendshëm, por i pëmbahen kodit të përgjithshëm të etikës.	Mediet private nuk kanë kode etike të brendshme. Ata i pëmbahen kodit të përgjithshëm të etikës - kodit AGM.	Mediet private nuk kanë miratuar kodet e brendshme të etikës. Ata i pëmbahen kodit të përgjithshëm të etikës. Ky dokument do të ndryshohet në të ardhmen e afërt për të përfshirë dispozita për mediet e reja dhe internetin.	Shumë pak medie kanë kodin e tyre të brendshëm të etikës. Shumica e mediave private i pëmbahen Kodit të Etikës të Këshillit të Mediave të Shkruara.	Shumica e mediave private nuk kanë kode të brendshme, por i pëmbahen Kodit të Etikës së Gazetarëve e miratuar nga dy shoqatat më të mëdha të gazetarëve: UNS dhe NUNS. Ekziston edhe një Kod i veçantë i Shoqatës së Medias Online.
Cilat janë format më të zakonshme të presionit që pronarët e mediave dhe menaxherët ushtrjnë mbi redaksitë apo tek gazetarët individual?	Format më të shpeshta të presioneve të përdorura nga pronarët e mediave dhe menaxherët janë të natyrës ekonomike. Këto presione krijojnë një nivel të lartë të censurës automatike mes gazetarëve.	Format e drejtpërdrejta të presionit: kërcënimet e humbjes së punës, kontratat e përkohshme të punës. Disa gazetarë (nga stacionet më të mëdha televizive) janë subjekt i shpotitjes.	Për shkak të frikës së pasojave, gazetarët nuk flasin haptazi rreth presioneve, por jashtë procesverbalit dëshmojnë rreth tyre dhe rregullojnë punën e tyre sipas vullnetit të redaktorëve dhe pronarëve.	Format më të zakonshme të presioneve janë kërcënimet e humbjes së vendit të punës, mungesës së kontratave të punës dhe pagat e vonuara.	Presionet mbi gazetarët nga pronarët e mediave nuk janë më drejtpërdrejta të ushtruara. Ato varen nga mediet specifike dhe nga pronari individual - gazetarët zakonisht e dinë paraprakisht se çfarë lejohet të shkruaj dhe çfarë jo.

B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në transmetuesit publik? (Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A e ka adoptuar transmetuesi publik kodin e mirësjelljes së gazetarëve dhe të pavarësisë editoriale? A e përfillin gazetarët këtë kod?	Të gjithë transmetuesit publik kanë miratuar kode editoriale të brendshme, por ato nuk janë të disponueshme në faqet e tyre të internetit. Në praktikë, këto kode shpesh nuk respektohen.	Në vitin 2017, MRT ka miratuar kodin e vet të etikës, megjithëse është kritikuar nga disa organizata të medias duke përfshirë AGM - Kodi parashihet ekzistencën e një organi etik brenda transmetuesit publik por nuk siguron transparencë në zgjedhjen e anëtarëve të atij trupi. Puna e këtij organi nuk është vlerësuar deri më tani.	RTCG ka kodin e vet etik për të gjithë të punësuarit. Një pjesë integrale e kontratave të punës të nënshkruara me gazetarët janë dispozitat e atij kodi etik. Megjithatë, nuk ka kod të veçantë të etikës për gazetarët. Pavarësia editoriale është një shqetësim për RTCG.	RTK ka kodin e vet të sjelljes dhe është perceptuar si i avancuar, por pavarësia editoriale është dobët e zbatuar në praktikë.	RTS dhe RTV nuk i kanë kodet e tyre specifike të parimeve etike të raportimit. Pavarësia editoriale është e paraparë me Ligjin dhe statutet, por nuk është njaftueshëm e zbatuar në praktikë.
A i kanë transmetuesit publik të krijuara rregulla të brendshme organizative që të mbajnë redaksitë të pavarura nga trupat menaxhues? A respektohen këto rregulla?	Transmetuesit publik i kanë të miratuara rregullat e brendshme organizative, por redaksitë nuk tregojnë pavarësi nga organet drejtuese. Ekzistojnë presione të shpeshta politike për punonjësit e transmetuesit publik.	MRT ka rregulla të brendshme organizative, por kjo nuk është një garanci se redaksitë e tij janë të pavarura nga organet drejtuese. Edhe pas rënies së qeverisë nacionaliste-populiste, perceptimi i kundërt vazhdon ende.	Kodi i etikës së RTCG-së përmban rregulla sjelljeje për anëtarët e Këshillit të transmetuesit publik, si dhe për sektorin menaxherial të transmetuesit dhe të punësuarit tjerë. Ai përmban parime të reklamimit.	RTK-ja ka rregullat e saja organizative, por redaksitë nuk janë të pavarura nga organet drejtuese.	Të dy transmetuesit publik kanë rregulla formale për të mbajtur redaksitë të ndara dhe të pavarura nga menaxhmenti, por në praktikë redaktorët dhe gazetarët nuk janë të pavarur.

**B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në transmetuesit publik?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria ushtron në redaksi apo te gazetarët individual në transmetuesin publik?	Mediet publike lokale financohen nga buxhetet komunale, gjë që ndikon në pavarësinë e tyre redaktuese. Gjatë emërimit të strukturave të menaxhimit në shërbimet publike, partitë në pushtet kanë ndikim të fuqishëm.	Masat disiplinore janë një praktikë e zakonshme në transmetuesin publik - zbritjet e pagave, lëvizja e punonjësve në pozita të tjera (të ulëta) në organizatë, marginalizim profesional. Nuk është vërtetuar nëse kjo ka ndodhur me ndryshimet politike në Shkup. Megjithatë, kjo ka ndodhur në RTM që nga pavarësia.	Shembulli më i qartë i presioneve të hapura mbi RTCG-në nga pushteti politik është shkarkimi i gjithë menaxhmentit dhe dy anëtarëve të Këshillit të RTCG-së nga pozicionet e tyre. Gjithashtu financimi shtetëror i transmetuesve publik lokal perceptohet si kërcënim i mundshëm për këto media.	Zyrtarët qeveritarë ndikojnë përmes menaxhimit të transmetuesit publik dhe diktojnë politikat editoriale.	Presionet janë të shpeshta dhe vijnë nga burime të ndryshme. Zyrtarët shtetërorë kritikojnë publikisht punën e shërbimeve të medias publike dhe kështu bëjnë presion ndaj tyre. Nga ana tjetër gazetaret vetë e dinë se cilat tema mund të publikojnë.
Cili ka qenë shembulli më ilustrativ i presionit të ushtruar nga qeveria në punën e tërë redaksisë apo ndonjë gazetari individual?	Në qershor të vitit 2018 drejtori i stacionit televiziv lokal RTV të kantonit Una-Sana u largua nga asambleja e kantonit. Mediat e tjera lokale gjithashtu janë subjekt i presioneve të ngjashme.	Në dy vitet e fundit situata e përgjithshme është e dukshme e relaksuar. Nuk ka dëshmi për të sugjeruar presionin e qeverisë aktuale në redaksitë siç kemi parë deri në vitin 2017. Më parë, incizimet e rrjedhura nga një praktikë e paligjshme e përgjimit të telefonave zbuluan se ndërmjet 2009 dhe 2016 zyrtarët qeveritarë kishin kërcënuar sigurinë e punës së gazetarëve të transmetuesit publik nëse nuk raportonin sipas linjave 'të dëshiruara'.	Drejtori i Përgjithshëm i transmetuesit publik Andrijana Kadija është larguar nga detyra. Arsyetimi ishte se ajo nënshkroi një kontratë me një OJQ që përmban dispozita që ndikojnë në politikën editoriale të RTCG. Në fakt, ky është një shembull i qartë i manovrimit politik.	Presioni i qeverisë ushtrohet nëpërmjet menaxhimit dhe redaktorëve të gazetarëve lidhur me lajmet. Nuk ka pothuajse asnjë raportim kritik që synon punën e qeverisë apo të institucioneve publike.	Drejtori i programit të RT Vojvodina u shkarkua nga posti i tij në maj 2016 nga anëtarët e Bordit të RTV, nën ndikimin politik. Në vitin 2017, gjykata ka vendosur se shkarkimi ishte i paligjshëm dhe detyroi RTV të rikthente redaktorin në pozicionin e tij. Në janar 2018 ai u përjashtua përsëri dhe gjykata vendosi përsëri në favor të tij. Çështja ende nuk është përfunduar.

**B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A e kanë mediat jo-fitimprurëse të adoptuar kodin e mirësjelljes së gazetarëve dhe të pavarësisë editoriale? A e përfillin gazetaret këtë kod?	Ka vetëm pak media joprofitabile (radio stacione) në sektorin e medieve tradicionale. Sidoqoftë, mediet online jo për përfitim janë duke u formuar në formën e OSHC-ve, të financuara nga donacionet e huaja (CIN, Zurnal, BIRN, Analiziraj, ba). Niveli i pavarësisë së tyre editoriale është shumë më i madh se në mediet private dhe transmetuesit publik.	Ekzistojnë vetëm disa radio stacione studentore jo fitimprurëse në Maqedoni. Ekzistojnë gjithashtu disa portale të lajmeve online të cilat janë themeluar si media jofitimprurëse dhe të cilat kryejnë shumicën e hulumtimeve serioze në vend. Këta kanë redaksi profesionale dhe i përmbahen më shumë standardeve etike.	Mediat jofitimprurëse nuk janë zhvilluar në Malin e Zi. Financimi i paqëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm i bën ata të mos kenë ndikim.	Ka shumë pak medie joprofitabile në Kosovë. Ato janë në përputhje me kodin e përgjithshëm të etikës së Komisionit të Pavarur për Media (për transmetim) dhe Këshillit të Medieve të Shkruara (për shtyp dhe internet).	Mediet jofitimprurëse në Serbi në përgjithësi nuk kanë kodet e veta etike. Ata pranojnë Kodin e Etikës të Gazetarëve. Ekziston një Kod i Shoqatës së Medieve Online. Udhëzimet për Zbatimin e Kodit të Etikës së Gazetarëve në Mjedisin Online janë prodhuar nga Këshilli i Shtypit.

**B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Cilat janë format më të zakonshme të presionit ndaj mediave jo-fitimprurëse?	Institucionet kanë tendencë të mbylljen kur është fjala për sigurimin e qasjes në informata dhe transparencë.	Nuk ka dëshmi për të sugjeruar se gazetarët nga redaksitë jo-fitimprurëse në dy vitet e fundit kanë qenë subjekt i presioneve serioze. Në të kaluarën ka pasur kallëzime ligjore dhe kërcënime verbale ndaj këtyre gazetarëve të bëra nga zyrtarë të lartë.	Problemi më i madh i mediave jofitimprurëse është mungesa e donacioneve për të financuar operacionet e tyre.	Ata nganjëherë referohen si "mercenarë të huaj" ose "spionë", sepse marrin fonde nga donatorë të huaj.	Presionet më së shpeshti ushtrohen përmes fushatave në medie që janë afër qeverisë. Gazetarët që punojnë në mediet jofitimprurëse quhen mercenarë të huaj dhe tradhtarë. Gjatë vitit të kaluar, sulmet ndaj këtyre gazetarëve nga zyrtarët qeveritarë janë intensifikuar.
Cili ka qenë shembulli më ilustrativ i presionit të ushtruar në mediat jo-fitimprurëse?	Kërcënimet verbale nuk janë të rralla. Linja e Ndhmës së Lirë regjistroi një incident në të cilin një politikan kërcënoi gazetarët nga Qendra për Gazetari Hulmuese.	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Ministri Nenad Popović ngriti katër padi kundër portalit hulmues të KRIK-ut, në çdo kërkesë prej një milion dinarë kompensimi për nderin, reputacionin dhe dinjitetin e dëmtuar. Paditë kanë të bëjnë me katër tekste të botuara në nëntor 2017, secila prej të cilave rendisin kryesisht të njëjtat të dhëna, bazuar në dosjet e rrjedhura në kuadër të projektit ndërkombëtar "Paradise Papers".

**B.5 Sa kanë liri gazetarët në procesin e prodhimit të lajmit?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Sa kanë liri gazetarët që të përzgjedhin lajme që ata punojnë dhe sa kanë liri për të vendosur se cili kënd i lajmit duhet të theksohet?	Sipas rezultateve të anketës, 19% e gazetarëve kanë raportuar se lajmet e tyre shpesh ndryshohen nga redaktorët, ndërsa rreth 13% thanë se tregimet e tyre shpesh nuk publikohen. Puna gazetareske shpesh nuk njihet dhe vlerësohet mjaftueshëm. Mes cilësisë së raportit dhe besnikërisë ndaj politikanëve të caktuar redaktorët shpesh do të zgjedhin këtë të fundit.	Të ballafaquar me këtë pozitë të pafavorshme, gazetarët në mediet publike dhe private rrallë punojnë në tema të ndjeshme dhe kryesisht mbulojnë ngjarjet e përditshme politike. Debatet në televizion privat tani janë më të zakonshme, por edhe në publik megjithatë.	Gazetarët në përgjithësi pohojnë se ata janë kryesisht të lirë në punën e tyre. Megjithatë disa probleme vazhdojnë: një e treta e gazetarëve të anketuar pohojnë se ata kanë shkallë të vogël lirie për zgjedhjen e temës së tyre. Gazetarët kanë më shumë liri të vendosin për këndin e temës së zgjedhur. 66% kanë deklaruar se janë të lirë të zgjedhin këndvështrimin e tyre.	Gazetarët nga Kosova theksojnë se redaktorët dhe pronarët kanë tendencë të ndikojnë në punën e tyre në rastet kur tregimi mund të hapë probleme sa i përket ndërhyrjes në interesat financiare të grupeve të caktuara ose interesave të tjera.	Gazetarët në shumë pak media gëzojnë këtë liri. Një studim i kohëve të fundit ka treguar se 47% e të anketuarve personalisht kanë dëshmuar kur redaktorët kanë refuzuar një propozim për të mbuluar tema të caktuara. Në 39% të të anketuarve kanë thënë se redaktorët u kanë kërkuar atyre të mbulojnë tema për të cilat nuk ka ndonjë justifikim profesional.
Sa shpesh marrin pjesë gazetarët në kordinimin redaktues dhe të redaksisë (pjesëmarrje në takimet e redaksisë apo dhënia e detyrave për gazetarët)?	Shumica e gazetarëve marrin pjesë rregullisht në takimet editoriale.	Intervistat e kryera nga AGM sugjerojnë se është e zakonshme që gazetarët në mediat më të mëdha nuk marrin pjesë në mbledhjet editoriale.	60% e gazetarëve shpesh ose rregullisht marrin pjesë në mbledhjet editoriale.	Shumica e gazetarëve marrin pjesë rregullisht në takimet editoriale.	62% e gazetarëve të intervistuar gjithmonë ose shumë shpesh marrin pjesë në takimet editoriale. Megjithatë, kjo praktikë varet shumë nga mediat në të cilat punon gazetari.

**B.5 Sa kanë liri gazetarët në procesin e prodhimit të lajmit?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Cilat janë vetë-perceptimet e gazetarëve në shkallën në të cilën ata kanë qenë të ndikuar nga burime të ndryshme të ndikimit: redaktorëve, menaxherët, pronarët, akterët politik, shteti?	Sipas anketës, gazetarët thanë se u përballën me presione (të përditshme ose shumë shpesh) nga burimet e mëposhtme: politikanët në pushtet (38%), pronarët e mediave (28,5%), redaktorët (28,5%), reklamuesit (23,2%).	Intervistat e kryera nga AGM sugjerojnë se redaktorët kanë shumë ndikim në përzgjedhjen e temave. Ende ekziston një perceptim që akterët politikë ndikojnë në përmbajtjen e medias.	Studimi në kuadër të këtij projekti tregon se ka ende një hierarki ndikimesh - në krye të strukturave që ndikojnë gazetarët janë redaktorët - 80% e gazetarëve kanë thënë se përmbajtja e tyre ndikohet nga redaktorët. Për më tepër, organet drejtuese në media ndikojnë në përmbajtje - 53% e të anketuarve thanë kështu. Pronarët e mediave janë në vendin e tretë. E fundit janë akterët dhe autoritetet politike. Me gjasë, ndikimi politik mbi gazetarët bëhet përmes redaktorëve të tyre.	Gazetarët pohojnë se redaktorët janë individët më me ndikim në punën e tyre.	Anketa e kryer në vitin 2016 me qëllim të këtij hulumtimi ka treguar se shumica e ndikimit vjen nga redaktorët - gati 77% e të anketuarve kanë thënë kështu. Megjithatë, studime të tjera kërkimore tregojnë se burimi i fundit i ndikimit janë akterët politikë.
Sa gazetarë kanë raportuar censurën? Sa gazetarët raportojnë se janë të nënshtruar ndaj vetë-censurës për shkak të frikës ose të humbjes së punës së tyre ose nga rreziqe të tjera?	Ndërmjet 23% dhe 26% të gazetarëve të anketuar u përgjigjën se censura ose vetëcensura është e pranishme në mediat e tyre.	Në vitin 2018, AGM ka regjistruar vetëm një rast të censurës. Gazetarët rrallë vendosin të reagojnë në rastet e censurës në Maqedoni dhe kur reagojnë ata insistojnë të qëndrojnë anonim.	Gazetarët janë të ndarë në vlerësimin e tyre lidhur me censurën e ndikimit që kanë në punën e tyre. 46% pretendojnë se censura ka ndonjë ndikim në punën e tyre, ndërsa 47% pohojnë se ndikimi i censurës në punën e tyre është minimal.	Gazetarët thonë se kolegët e tyre e dinë paraprakisht se çfarë dhe si të raportojnë, duke pasur parasysh përvojën e tyre të mëparshme me ndikimin që vjen nga pronarët ose redaktorët.	Në Serbi ekziston një perceptim i gjerë midis gazetarëve se censura nuk ekziston më dhe se vetë-censura mbizotëron. Vetëcensurimi nxitet nga frika për sigurinë financiare. Mediet lokale janë veçanërisht të cenueshme.



C.1 Statistikat e Sigurisë dhe Mosndëshkimit (Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018; për vrasjet 15-20 vite prapa)

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Numri dhe llojet e kërcënimeve <u>kundër jetës së gazetarit</u> dhe <u>llojet tjera të kërcënimeve</u> .	Sipas Linjes së Ndhmës për Medie të Lira, ishin gjithsej 16 kërcënime verbale dhe të tjera, përfshirë një kërcënim me vdekje.	1 (një) kërcënim verbal me vdekje është regjistruar në periudhën raportuese.	1 (një) kërcënim verbal me vdekje është regjistruar në periudhën raportuese.	Janë regjistruar 24 raste të kërcënimeve verbale dhe të tjera. Prej tyre, 7 ishin kërcënime kundër jetës së gazetarëve.	21 raste të kërcënimeve verbale dhe të tjera u regjistruan në periudhën raportuese.
Numri i <u>sulmeve aktuale</u> . Sa gazetarë janë sulmuar?	U evidentuan 5 sulme aktuale (1 ishte tentativë vrasjeje, 1 ishte sulm ndaj automjetit të gazetarëve ku një pjesë e oronës ishte dëmtuar dhe 3 ishin sulme fizike ndaj gazetarëve). Në 2 nga këto raste gazetarët ishin parandaluar të raportojnë nga ngjarje të caktuara me dhunë fizike.	U regjistruan 5 sulme aktuale (1 sulm fizike, 2 arrestime arbitrare të gazetarëve, 1 dëmtim të pronës së gazetarëve dhe 1 parandalim nga raportimi).	3 sulme aktuale u regjistruan (1 ishte përpjekje për vrasje, 1 ishte hedhje e një pajisje shpërthyesë para një shtëpie të gazetarit dhe 1 djegje e një makine gazetari).	4 sulme aktuale u regjistruan (3 gazetarë janë sulmuar fizikisht dhe 1 ishte arrestim arbitrar).	7 sulme aktuale u regjistruan (6 sulme fizike ndaj gazetarëve dhe 1 sulm ndaj pronës së një gazetari).

**C.1 Statistikat e Sigurisë dhe Mosndëshkimit
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018; për vrasjet 15-20 vite prapa)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
Numri dhe lloji i <u>vrasjes</u> . Sa gazetarë janë vrarë në <u>15-20 vitet e fundit</u> ?	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Zyrtarisht, nuk ekzistojnë raste të tilla.	1 vrasje: 2004. Më 2004, Dusko Jovanovic, kryeredaktori i së përditshmës Dan, ishte vrarë.	Nuk ka raste të tilla në dekadën e fundit. Nga 1998 gjer më 2005, janë vrarë dhe zhdukur 14 gazetarë. 8 prej tyre janë vrarë, gjersa 6 prej tyre konsiderohen ende si persona të zhdukur.	3 vrasje: 1994, 1999 dhe 2001. Më 1994, Radislava Dada Vujasinovic, gazetarë e magazinës Duga; më 1999, Slavko Curuvija, gazetar, kryeredaktor dhe pronar i Daily Telegraph; më 2001, Milan Pantic, correspondent i Vecernje Novosti, nga Jagodina.
Numri dhe lloji i <u>kërcënimeve dhe sulmeve në institucione mediale, organizata media dhe asociacione të gazetarëve</u> .	30 prej të cilave shumica e tyre iu adresohen gazetarëve të BeH.	Nuk ka raste të tilla.	1 rast është regjistruar. Hapësirat e gazetës Sloboda ishin dëmtuar më Tetor 2017.	2 raste ishin regjistruar. Një portal lajmesh ishte sulmuar tri herë në një periudhë të shkurtër kohore. Një medium ishte kërcënuar nga një person përmes telefonit.	9 raste ishin regjistruar. Asociacionet e gazetarëve që kritikojnë qeverinë ishin subjekt i vazhdueshëm i presioneve, sulmeve dhe frikësimeve.

**C.2 A marrin përgjegjësi institucionet shtetërore dhe akterët politik për mbrojtjen e gazetarëve?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A kanë zhvilluar institucionet shtetërore politika specifike që përkrahin mbrojtjen e gazetarëve online dhe ata të shtypit? Nëse po, a është zbatimi i këtyre politikave i siguruar me burime dhe ekspertizë të mjaftueshme?	Disa zhvillime pozitive në vitin 2017: Avokati i Popullit për të Drejtat e Njeriut botoi Raportin Special për Statusin dhe Rastet e Kërcënimeve ndaj Gazetarëve në BeH; Ministria e Drejtësisë filloi takime që synonin përmirësimin e nivelit të sigurisë së gazetarëve.	Institucionet shtetërore nuk kanë zhvilluar akoma politika ose masa specifike për mbrojtjen e gazetarëve. Mosndëshkimi ende paraqitet si një problem.	Institucionet shtetërore nuk kanë zhvilluar akoma politika ose masa specifike për mbrojtjen e gazetarëve. Ekziston një perceptim i përgjithshëm se një përparim i kufizuar është arritur në zgjidhjen e rasteve të shkuara të dhunës kundër gazetarëve.	Politikat gjithëpërfshirëse për të mbështetur mbrojtjen e gazetarëve ende nuk janë zhvilluar. Prokuroria e Shtetit ka caktuar prokurorë në pesë qendra për t'u marrë me këtë çështje. Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar një koordinator për t'u marrë me rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve.	Politikat gjithëpërfshirëse ende nuk janë zhvilluar, por deri më tani janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm: Marrëveshja për bashkëpunimin dhe masat për ngritjen e niveleve të sigurisë lidhur me sigurinë e gazetarëve të nënshkruar në vitin 2016; Grupi punues i përhershëm i përbërë për të përmirësuar mbrojtjen e gazetarëve, por në nëntor 2017 pesë gazetarët dhe asociacionet e mediave pezulluan pjesëmarrjen e tyre, sepse ata nuk ishin të kënaqur me punën e grupit.

**C.2 A marrin përgjegjësi institucionet shtetërore dhe akterët politik për mbrojtjen e gazetarëve?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A ka mekanizma (institucione, programe dhe bugjet) për monitorim dhe raportim për kërcënime, ngacmime dhe dhunë kundrejt gazetarëve? Kush i monitoron dhe mban të dhëna për sulmet dhe kërcënimet? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna të azhuruara rreth sulmeve ndaj gazetarëve dhe pandëshkueshmërisë? Cilat masa janë marrë pas incidentit dhe nga kush?	Nuk ka mekanizma specifikë. Linja e ndihmës falas për mediat është ende mekanizmi i vetëm që shpërndan të dhëna për të gjitha institucionet shtetërore, organizatat mediatike dhe organizatat ndërkombëtare.	Nuk ka mekanizma specifikë. Regjistri i AGM-së është baza e vetme ekzistuese e të dhënave. Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme konfirmoi problemin e mosdëshkimit. Nga 59 sulme në pesë vitet e fundit, vetëm 2 autorë ishin të sanksionuar.	Nuk ka mekanizma specifikë. Aktualisht, nuk ka prova të veçanta për kërcënimet, ngacmimet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Të dhënat statistikore të regjistruara nga Policia janë shumë të përgjithshme. Zyrtarët e Policisë deklaruan se një pozicion i ri pune do të hapet posaçërisht për trajtimin e kësaj çështjeje.	Nuk ka mekanizma të tillë, por disa masa janë ndërmarrë: Gjykata Themelore në Prishtinë synon të zhvillojë një bazë të dhënash për rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve. Policia e Kosovës tashmë ka një bazë të të dhënave, por ka rënë dakord të detyrojë Departamentin e Krimeve të Rënda që të merren me rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve.	Nuk ka mekanizma të tillë, por disa masa janë ndërmarrë: Zyra e Prokurorisë Publike miratoi Udhëzimin për mbledhjen e provave të krimeve kundër gazetarëve dhe sulmet në faqet e internetit. Masat urgjente janë parashikuar në rast të sulmeve ndaj gazetarëve. Informacioni për rastet e mbledhura nga prokuroria publike është dorëzuar në asociacionet e gazetarëve deri në fund të vitit 2017, por kjo praktikë u ndal në vitin 2018. Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka miratuar asnjë udhëzim dhe nuk ka filluar mbajtjen e shënimeve.
A njihen sulmet në sigurinë e gazetarëve nga institucionet qeverisëse si shkelje të lirisë së shprehjes, ligjit të drejtave të njeriut dhe ligjit penal? A i bëjnë zyrtarët publik deklaratat e tyre të qarta se i njohin sigurinë e gazetarëve dhe a i dënojnë sulmet mbi ta?	Disa politikanë dhe institucione shtetërore filluan t'i kushtojnë më shumë vëmendje kësaj çështjeje dhe më shpesh dënojnë sulmet ndaj gazetarëve në deklaratat e tyre publike. Për shembull, sulme të tilla njihen si një shkelje e lirisë së shprehjes në reagimet publike të Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut.	Zyrtarët publik shpesh i dënojnë sulmet ndaj gazetarëve, por institucionet shtetërore ende nuk i njohin mjaft këto sulme si një shkelje të lirisë së shprehjes.	Pothuajse të gjitha sulmet janë dënuar nga zyrtarët publikë. Megjithatë, numri i rasteve të pazgjidhura të dhunës apo kërcënimeve është ende shumë i madh, ndërsa disa raste tashmë janë të vjetra.	Zyrtarët publikë dënojnë sulme, por vetëm në raste serioze.	Megjithëse institucionet shtetërore kanë ndërmarrë disa masa, kjo ende nuk është e mjaftueshme. Zyrtarët shtetërorë nuk e kuptojnë rolin e gazetarëve në shoqëri. Ata rrallë i dënojnë sulmet ndaj gazetarëve dhe nëse e bëjnë këtë, atëherë kjo bëhet më së shumti në baza selektive.
A ekziston ndonjë dokument i adoptuar nga institucionet shtetërore të cilat japin udhëzime për ushtrinë dhe policinë dhe ndalojnë ngacmimin, frikësimin apo edhe sulmet fizike ndaj gazetarëve?	Dokumentet specifike të miratuara nga institucionet shtetërore nuk ekzistojnë. Ekzistojnë udhëzime të Policisë në trajtimin e mediave dhe udhëzimeve të medias në trajtimin e policisë, të miratuara me mbështetjen e OSBE-së. Megjithatë, këto udhëzime duhet të përditësohen.	Dokumente specifike të miratuara nga institucionet shtetërore nuk ekzistojnë.	Dokumentet specifike të miratuara nga institucionet shtetërore nuk ekzistojnë.	Dokumentet specifike të miratuara nga institucionet shtetërore nuk ekzistojnë.	Dokumentet specifike të miratuara nga institucionet shtetërore nuk ekzistojnë. Dokumenti i vetëm ekzistues është Udhëzimi për mbledhjen e dëshmive e krimeve kundër gazetarëve dhe sulmet në faqet e Internetit.

**C.2 A marrin përgjegjësi institucionet shtetërore dhe akterët politik për mbrojtjen e gazetarëve?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A bashkëpunojnë institucionet e shtetit me organizatat e gazetarëve rreth çështjeve të sigurisë së gazetarëve? A përmbahen institucionet e shtetit nga miratimi apo promovimi i kërcënimeve ndaj gazetarëve?	Disa institucione shtetërore - Ministria e Drejtësisë dhe Avokati i Popullit për të Drejtat e Njeriut, treguan gatishmëri për të bashkëpunuar ngushtë me gazetarët e BeH.	Në përgjithësi, bashkëpunimi ndërmjet AGM dhe institucioneve shtetërore është i mirë, por efektet e këtij bashkëpunimi ende mungojnë.	Bashkëpunimi i mirë është krijuar ndërmjet Sindikatës së Mediave të Malit të Zi dhe Avokatit të Popullit, ndërsa bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Prokurorinë e Lartë të Shtetit është vetëm në fazën fillestare.	Bashkëpunimi fillestar i mirë është themeluar ndërmjet AGK-së dhe Prokurorisë së Shtetit, Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Policisë së Kosovës.	Marrëveshja e vitit 2016 e nënshkruar me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurorinë Publike dhe asociacionet e gazetarëve dhe medieve ka kontribuar në drejtim të komunikimit më të mirë, raportimit më të lehtë dhe informacionit më të detajuar mbi rastet e sulmeve dhe kërcënimeve. Megjithatë, numri i rasteve të pazgjidhura është ende shumë i madh, edhe pse ky është një nga objektivat kryesore të Marrëveshjes së nënshkruar. Nga 28 raste në 2017, vetëm një rast është zgjidhur.
Në raste të përgjimeve elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore larine e shprehjes dhe privatesinë? Cili ka qenë rasti më i fundit të përgjimit elektronik ndaj gazetarëve?	Nuk ka dëshmi për raste të tilla.	Nuk ka dëshmi për raste të tilla.	Nuk ka dëshmi për raste të tilla.	Nuk ka dëshmi për raste të tilla.	Nuk ka dëshmi të besueshme për raste të tilla. Nuk ka kontroll efikas mbi organet shtetërore përgjegjëse për mbikëqyrjen elektronike.

**C.3 A merret në mënyrë efektive sistemi i drejtësisë penale dhe civile me kërcënime dhe akte të dhunës kundër gazetarëve?
(Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)**

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A ekzistojnë institucione/njësi specifike të dedikuara në hetime, ndjekje, mbrojtje dhe kompensim në mënyrë që të sigurohet siguria e gazetarëve dhe çështja e mosdëshkueshmërisë?	Nuk ka njësi / departamente të tilla. Rastet e dhunës kundër gazetarëve nuk janë regjistruar në mënyrë specifike në bazën e të dhënave të gjykatave dhe nuk mund të merren veç e veç, të gjurmohen ose të raportohen.	Nuk ka njësi / departamente të tilla.	Nuk ka departamente / njësi të tilla. Ekziston vetëm një Komision për monitorimin e hetimeve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe medieve, mandati i të cilit është zgjatur edhe për dy vjet të tjera. Komisioni në vitet e fundit ka identifikuar një numër mangësish në hetimet e 15 rasteve të monitoruara.	Janë ndërmarrë disa masa: Prokuroria e Shtetit ka një koordinator që koordinon punën e prokurorëve vendorë të caktuar lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të sulmeve ndaj gazetarëve. Policia e Kosovës kohët e fundit vendosi që departamenti i saj për krime të rënda duhet të merret me rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve.	Nuk ka departamente / njësi të tilla. Ekziston vetëm një Komision për shqyrtimin e fakteve në lidhje me hetimin e vrasjeve të gazetarëve. Në gusht të vitit 2018, Qeveria zgjeroi kompetencat e Komisionit për shqyrtimin e hetimeve për vrasjet dhe zhdukjet e gazetarëve në Kosovë në periudhën 1998-2001, si dhe për vrasjen e gazetarëve gjatë konflikteve që kanë ndodhur në ish-Jugosllavi, nga 1991 deri në 1995.

C.3 A merret në mënyrë efektive sistemi i drejtësisë penale dhe civile me kërcënime dhe akte të dhunës kundër gazetarëve? (Periudha raportuese: 1 Shtator 2017 – 31 Gusht 2018)

Treguesit	Bosnja e Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosovë	Serbia
A ekzistojnë procedura speciale në vend që mund të merret me sulmet ndaj grave, përfshirë gazetarët gra?	Nuk ka procedura të tilla. Gratë në poste të ndryshme në medie, duke përfshirë gazetarët, janë subjekt i presioneve më të mëdha politike dhe presioneve tjera. Institucionet nuk kanë mekanizma specifikë për të trajtuar këtë problem.	Nuk ka procedura të tilla.	Nuk ka procedura të tilla.	Nuk ka procedura të tilla.	Nuk ka procedura të tilla.
A ofrojnë agjencitë shtetërore burime adekuate për të mbuluar hetimet e kërcënimeve dhe veprave të dhunës kundër gazetarëve?	Agjencitë shtetërore shpesh nuk sigurojnë burime adekuate kur është e nevojshme, por praktikë tregoi se kur ka interes për një rast specifik, reagimet mund të jenë të shpejta dhe efikase.	Burime të mjaftueshme nuk janë siguruar akoma nga institucionet shtetërore.	Burime adekuate nuk janë siguruar akoma nga institucionet shtetërore. Hetimet janë shumë të ngadalshme dhe me rezultate të dobëta.	Burime të mjaftueshme nuk janë siguruar akoma nga institucionet shtetërore. Mbetet të shihet nëse do të zbatohen masat e paralajmëruara nga Policia e Kosovës për të obliguar Departamentin e saj të Krimeve të Rënda për t'u marrë me këtë çështje.	Burime adekuate nuk janë siguruar akoma nga institucionet shtetërore.
A ofrohen masat e mbrojtjes për gazetarë kur kërkohen në përgjigje të kërcënimeve serioze kundrejt sigurisë së tyre fizike?	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Nuk ekzistojnë raste të tilla.	Nuk ekzistojnë dëshmi për masa të tilla.	Nuk ekzistojnë dëshmi për masa të tilla.	Disa gazetarë ishin nën mbrojtje të policisë, por problemi me këto raste është që masa të tilla zgjasin shumë. Për shembull, një gazetar nga Serbia ka qenë nën mbrojtjen e policisë për më shumë se 12 vjet.
A janë hetuar menjëherë, në mënyrë të pavarur dhe efikase hetimet e krimeve kundër gazetarëve, përfshirë kërcënimet dhe frikësimet?	Autoritetet hetuese, policia dhe prokurorët bëjnë punën e tyre ngadalë, veçanërisht në kryerjen e hetimeve efektive dhe të plota të sulmeve dhe veprave të tjera penale kundër gazetarëve.	Bazuar në dëshmitë e AGM-së, hetimet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve nuk kryhen menjëherë dhe me efikasitet.	Hetimet janë të ngadalta dhe shpesh joefikase. Vetëm dy raste nga 2018 u zgjidhën menjëherë pas ndodhjes së tyre. Rasti më serioz i një përpjekjeje për vrasje nuk është zgjidhur akoma.	Rastet hetohen menjëherë dhe në mënyrë të pavarur, por procedurat gjyqësore janë shumë të ngadalta.	Hetimet nuk kryhen menjëherë dhe në mënyrë efikase. Ka ende një numër të madh rastesh të pazgjidhura. Procedurat gjyqësore zgjasin shumë, shpesh pa vendime përfundimtare. Tri rastet e vrasjeve nuk janë zgjidhur ende.
A janë hetimet efektive për dhunë dhe kërcënime të kryera kundër zinxhirit të plotë të akterëve në sulme, duke përfshirë nxitësit / organizatorët dhe autorët e veprave penale?	Kur kryerësit janë politikanë, zyrtarë publikë ose individë të tjerë të fuqishëm, ndjekjet efektive shpesh nuk kryhen.	As kryerësit e sulmeve ndaj gazetarëve nuk ndëshkohen, dhe as hetimet e nxitësve nuk fillojnë.	Problemi më i madh është akoma fakti që nxitësit nuk janë zbuluar kurrë. Kjo dëshmohej nga rasti i vrasjes së Dushko Jovanović, për të cilin edhe pas 14 vitesh vetëm një bashkëpunëtor u dënua.	Jo. Nxitësit e vërtetë apo organizatorët nuk zbulohen kurrë.	Vetëm autorët janë identifikuar dhe dënuar, ndërsa organizatorët mbeten të pafund identifikuar.
A siguron Shteti trajnime dhe kapacitete të duhura të ofruara policisë, prokurorëve, avokatëve dhe gjyqtarëve për sa i përket mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe gazetarëve?	Deri tani janë organizuar disa forma të trajnimit për ndërtimin e kapaciteteve të zyrtarëve policorë, prokurorëve dhe gjyqtarëve, por ato ende janë të pamjaftueshme.	Disa forma të trajnimeve janë organizuar për policët dhe prokurorët, me mbështetjen e OSBE-së në Maqedoni.	Disa forma të trajnimit u organizuan me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës JUFREX në gjysmën e parë të vitit 2018 për: 9 prokurorë shtetërorë, 34 gjyqtarë, 7 këshilltarë në gjykata dhe një në Prokurorinë e Shtetit. Ka plane për të vazhduar me trajnime të ngjashme.	Ekziston një projekt në vazhdim në Kosovë që ofron trajnime për prokurorët dhe gjyqtarët në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe gazetarëve.	Disa raunde trajnimesh janë parashikuar me Marrëveshjen për bashkëpunimin dhe masat për ngritjen e niveleve të sigurisë lidhur me sigurinë e gazetarëve të nënshkruara në vitin 2016, por ato ende nuk janë zbatuar.

